

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR**  
**TIRANE**

---

**Nr. 976 AKTI**  
**Dt.Rregj.06.06.2017**

**DT.19.07.2017**

**V E N D I M**  
**NE EMER TE REPUBLIKES**

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, e perbere prej:

**GJYQTAR: ARBEN MICKAJ**

Asistuar prej sekretares **Merita Drishti(Kuci)**, pas shqyrtimit ne seance gjyqësore me dyer te hapura, sot me datë **19.07.2017**, lidhur për çeshtjen penale me Nr. 976 Akti dhe date ardhje 06.06.2017, e qe i perket:

**K E R K U E S:**

**A. K**, i biri i A. dhe i E.,  
dtl.18.07.19.., lindur ne Gjirokaster dhe banues ne  
Tirane, Rr.” 5Maji”, me arsim te larte, me shtetesi  
shqiptare, i padenuar, hetuar me masë sigurimi  
“Detyrim per tu paraqitur në policinë gjyqësore”.  
Mbrojtur ne gjykim nga Av. Bashkim Nikolli me  
nr. 1623 license.

**PERSON NË GJYKIM:**Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë  
përfaqësuar nga prokurori **Dritan Nushi**.

**O B J E K T I:**

Heqje e sekuestros mbi lejen e drejtimit te mjetit qe  
i perket kerkuesit A. K.

**BAZA LIGJORE:**

Nenet 274 të K.Pr.Penale.

Gjykata, si dëgjoi perfaqsesin e kërkesit A. K, Av.Bashkim  
Kamulla i cili kerkoi pranimin e kerkeses per heqje e sekuestros mbi lejen e  
drejtimit te mjetit qe i perket kerkuesit A. K , prokurorin Dritan  
Nushi, i cili kërkoj rrezimin e kesaj kerkese dhe pasi shqyrtoi aktet e bisedoi  
çeshtjen;

**V Ë R E N**

Se nga kërkuesi A. K më datë 06.06.2017 është depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkesa me objekt heqje heqje e sekuestros mbi lejen e drejtimit të mjetit që i perket kerkuesit A.K Rezultoi në gjykim, se me vendimin nr.... date 18.05.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shtetasi A. K është deklaruar:

- fajtor për kryerjen e veprës penale të “**Drejtimit mjeti në mënyrë të parregullt**» dhe në bazë të nenit 291 të Kodit Penal dënimit e tij me 3(tre) muaj burgim.
- Në bazë të nenit 406 të K.Pr.Penale i ulet 1/3 e dënimit duke u denuar i pandehuri **A. A. K** me 2 (dy) muaj burgim.
- Bazuar në nenin 63 të K.Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, duke e zëvendësuar me 60 ore punë në interes publik pranë Bashkisë Tiranë.
- Puna në interes publik të kryhet brenda një afati prej 6(gjashtë) muajsh duke u detyruar i denuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës.
- Shpenzimet procedurale në hetimet paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurit.

Gjate shqyrtimit të kërkesës të bërë nga kërkuesi A.K, gjykata konstatoi se gjate hetimeve për procedimin penal për të pandehurin A. K kryer nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale të “Drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 të Kodit Penal, prokurori i ceshtjes ka vendosur sekuestron e lejes së drejtimit për të pandehurin A. K. Kjo leje drejtimi ndodhet në fashikullin e gjykimit i cili aktualisht ndodhet në Gjykatën e Apelit Tiranë, mbasi vendimi nr.1609, date 18.05.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është ankimuar nga prokurori i ceshtjes.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr...., date 18.05.2017 nuk ka vendosur në bazë të nenit 60 pika 4 e Kodit Penal që i pandehuri të ndalohej të drejtoje automjete për një periudhë të caktuar.

Përsa me sipër, gjykata vendosi të rrezojë kërkesën, kerkuesit A. K duke i sugjeruar të drejtohet Gjykatës së Apelit Tiranë si gjykate kompetente për shqyrtimin e kësaj kërkesë.

**Në referim të nenit 274 të K.Pr.Penale,**

**V E N D O S I**

- Rrezimin e kerkeses penale me Nr. 976 Akti dhe date ardhje 06.06.2017, me kerkues **A. A. K**, me objekt “Heqje mase sekuestroje”, si te pabazuar ne prova dhe ligj.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohet kërkuesit.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, sipas ligjit.
- **U shpall sot në Tiranë, më datë 19 Korrik 2017.**

**S E K R E T A R E**

**G J Y Q T A R**

**Merita Drishti(Kuci)**

**ARBEN MICKAJ**